



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GRACANICA

Numri i lëndës: 2019:180202

Datë: 20.01.2025

Numri i dokumentit: 06730090

P.nr. 203/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GRAQANICË-Departamenti i Përgjithshëm , divizioni Penal, gjyqtari Rrustem Begolli, me zyrtarën ligjore Blerta Bekteshi, duke vendosur sipas detyrës zyrtare në çështjen penale kundër të pandehurës J. S. M., për shkak të veprës penale vjedhje e sherbimeve nga neni 320 të KPRK-së , i akuzuar sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.nr.3763/19 të datës 19.08.2019, me datë 17.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

H U D H E T akuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.nr.3763/19 të datës 19.08.2019 dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurës **J. S. M.**, nga e ëma Dragica , e lindur me datën në Prishtinë, me vendbanim në fshatin Badovc i ri Komuna e Graqanicës ku edhe jeton , Sërbe, shtetas i Republikës së Kosovës.

Për shkak të veprës penale vjedhje e sherbimeve nga neni 320 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë departamenti i përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.nr.3763/19 të datës 19.08.2019 kundër të pandehurës J. S. M., për shkak të veprës penale vjedhje e sherbimeve nga neni 320 të KPRK-së.

Gjykata pas shumë përpjekjeve dhe veprimeve konform dispozitave ligjore, ka bërë përpjekje që të përfundoj këtë çështje penalo juridike. Edhe përkurër veprimeve të ndërmara nuk ka aritur që të përfundoj për shkak të mungesë së të pandehurit.

Gjyqtari i çështjes këtë lënd e ka pranuar me datë 03.10.2022

Gjyqtari i vetëm gjykues pas pranimit të lëndës dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të saj e duke vepruar sipas detyrës zyrtare, konstatoi se në rastin konkret ka arritur afati kohor i ndalesës absolute të ndjekjes penale, ngase sipas dispozitave të nenit 106 par.1 pika 1.5 të KPK-së, vepra penale e cila është e dënueshme deri në 3 vitë burgim parashkruhet kur të kanë kaluar 3 vite nga data e kryerjes së veprës penale, kurse sipas dispozitave të nenit 107 par. 8 të KPK-së, ndjekja penale ndalohet në çdo raste kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, ndërsa në rastin konkret kanë kaluar më shumë se 6 vite nga koha e kryerjes së veprës penale , ngase vepra penale është kryer me dt: 09.01.2019 ndërsa ndalesa absolute e ndjekjes penale është arritur me dt: 09.01.2025.

Vendimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve procedurale dhe paushallit është marrë në bazë të nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë gjykata konstaton se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore që kundër të pandehurit të hedhet akuza dhe të pushohet procedura penale, prandaj në pajtim me nenin 106 par.1.5, 107 par 8 të KPK-së, si dhe nenin 253 par.1 nën par. 1.3 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GRAQANICË-Departamenti i
Përgjithshëm divizioni Penal,
P.nr.203/2020, datë 17.01.2025**

Zyrtarja Ligjore,
Blerta Bekteshi

Gjyqtari,
Rrustem Begolli

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, mund të paraqesin ankesë personat e autorizuar, brenda tri (3) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate, duke ju drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë.